

VENDIMET E BORDIT TË DATËS 28 DHJETOR 2020

Vendimi Nr. 2020-39

Plan Buxheti 2021- Leximi i parë

- Miratohet me shumicë votash leximi i parë i plan buxhetit 2021.
- Plan buxheti 2020 do të prezantohet në kuvendin e rregullt për aprovim nga komuniteti.

Vendimi Nr. 2020-40

Komisioni për shpalljen e më të mirëve 2020

- Në harmoni me pikën 2.2. të rregullores 06 për çmimet vjetore bordi me shumicë votash miraton komisionin për shpalljen e më të mirëve 2020.
- Në komision emërohen: 1) Gëzim Mehmedi, 2) Kreshnik Arifi, 3) Senad Jusufi. Ndërkaq anëtarët rezervë të miratuar nga bordi janë: 1) Blerim Koro, 2) Astrit Xërxa.
- Anëtarët do të kontaktohen nga administrata për të konfirmuar pjesëmarrjen, dhe për të filluar punën në harmoni me rregulloren #06 për çmimet vjetore.

Vendimi Nr. 2020-41

Shpërblimet më të mirëve 2020

- Bazuar në vendimin e bordit të datës 17.09.2020 nr 2020-19 për mos organizmin e ceremonisë së laureatëve për vitin 2020 si pasojë e ndikimit të pandemisë Covid – 19, bordi me shumicë votash merr vendim që këtë vit të mos ndahen as shpërblime, në përjashtim të kategorisë adult.
- Shpërblimi për kategorinë adult do të jetë nën linjën buxhetore që e parasheh rregullorja 05 për më të mirët e vitit.

Vendimi Nr. 2020-42

Nominimi për pjesëmarrje në komisionet e Tennis Europe

- Bazuar në pikën 6.5 të statutit të FTK-së, bordi me shumicë votash ka miratuar propozimin që z. Shklezen Domi të jetë i nominuar nga federata për të qenë anëtar në ndonjërin nga Komisionet funksionale të Tennis Europe.
- FTK do të nominoi z. Domi për pjesëmarrje ndërkaq që përzgjedhja finale do të bëhet nga bordi i Tennis Europe.



Vendimi Nr. 2020-43

Rregullorja 05 për garat zyrtare

- Miratohet me shumicë votash rregullorja 05 për garat zyrtare të FTK-së.
- Rregullorja hynë në fuqi më 01 janar 2021.

Vendimi Nr. 2020-43

Rregullorja 04 për rankingun zyrtare

-Miratohen me shumicë votash ndryshimet e propozuara në rregulloren 04 për rankingun zyrtar.

Ndryshimet e miratuara janë:

1. Largimi i rangut për grupmoshat U12-Adult;
 2. Përfshirja e pikëve fikse për secilën turne të kategorive U12-Adult
 3. Marrja në konsideratë vetëm 6 turnet me më së shumti pikë për ranking;
 4. Përfshirja e rregullave Masters në rregulloren 04;
 5. Largimi i kampionateve të miqësura
 6. Largimi i rregullave të rankimit gjatë periudhës së pandemisë.
- Rregullorja me ndryshime do të hyjë në fuqi më 01.01.2021.

Vendimi Nr. 2020-44

Kuvendi Zgjedhor 2021 dhe ai i rregullt 2020

- Në harmoni me pikën 6.3 të statutit të FTK-së për organizimin e zgjedhjeve të rregullta, bordi me shumicë votash merr vendim që zgjedhjet të mbahen më dt. 27 Shkurt 2021.
- Kuvendi do të jetë edhe i rregullt për prezantimin e punës të vitit 2020, si dhe zgjedhor.
- Bordi inkuadron kandidatët të paraqesin kandidaturën 15 ditë më herët në emailin federation@tenniskosova.com , duke bashkëlidhur një cv dhe letër motivuese.

Vendimi Nr. 2020-45

Përleshja fizike mes Granit Bajraliu dhe Durim Morina

- Bordi me shumicë votash merr vendim që komisioni disiplinor i aprovuar nga bordi më 17.09.2020 me vendimin nr 2020- 36 të angazhohet për trajtimin e rastit të përleshjes fizike mes KT Rilindja dhe KT Kalaja.



- Palet do të ftohen që në një afat prej 5 ditësh të japin komentet e tyre rreth ankesës, ndërkohë që pas kësaj date të fillohet puna nga komisionin disiplinor.